



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

ECURIA E SURVEJANCËS SINDROMIKE "ALERT" PËR PERIUdhËN
16 QERSHOR – 22 QERSHOR 2014
(JAVA 25)

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË,
KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË,
PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 25

	JAVA 25
DIARRE PA GJAK	1.786
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	6.900
INF. RESP. TE POSHTËME	3.427
RASH ME TEMPERATURË	32
VERDHEZA	2
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	401
% e Njësive Raportuese	94% (401/427)

Rash me temperaturë

- Virusi i Varicellës qarkullon në disa rrethe të vendit dhe ka shkaktuar epidemi në grupmoshën pediatrike 1- 14 vjeç. Fëmijët nuk kanë shfaqur komplikacione.

22 raste janë raportuar nga rrethi i Tiranës, 3 raste nga rrethi i Vlorës dhe 7 raste nga rrethi Fierit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rretheve përkatës, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

- Mostrat e marra nga pacientët kanë rezultuar pozitive për antikorpe IgM ndaj virusit Varicella-zoster.
- 8 mostra të cilat kanë rezultuar negative për Varicelë janë testuar edhe për Fruth dhe Rubeolë dhe kanë rezultuar negative.

Verdhëz

1 rast i grupmoshës 5-14 vjeç me diagnozë “Hepatit viral i paspecifikuar” është raportuar nga rrethi i Elbasanit dhe 1 rast grupmoshës 15-44 vjeç është raportuar nga rrethi i Fierit me diagnose të konfirmuar “Hepatit viral B”.

Rastet janë hospitalizuar dhe në vatër janë marrë masat e kontrollit dhe të parandalimit.

Paralizë Flakside Akute (PFA)


Janë raportuar dy raste me PFA nga Spitali Pediatrik QSUT.

-Një rast i moshës 2.5 vjeç është nga rrethi i Durrësit dhe ekzaminimi laboratorik i feçeve ka rezultuar negativ.


-Rasti tjetër është i moshës 5 muaj nga rrethi i Tiranës. Fëmija ka marrë vaksinë orale të Poliomiellitit në datën 26. 04. 2014 dhe pas 40 ditësh i është shfaqur paraliza e ekstremiteteve të poshtëme.

Ekzaminimi laboratorik i feçeve rezultoi pozitiv për virusin e Poliomiellitit që me shumë gjasa është shtam vaksinal. Hetimi epidemiologjik është në proces.

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 25-të krahasuar me javën paraardhëse, java e 24-të.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarreve pa gjak” paraqet 14% rritje në javën e 25-të krahasuar me javën paraardhëse, java e 24-të.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 25 të vitit 2013 dhe të vitit 2014. Numri i rasteve.




Vërehet që numri i Infeksioneve respiratore akute në javën 25 është 9% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 24 dhe javën e 25 të vitit 2014. Incidenca (raste/10.000)




**Trendi i “Diarre pa Gjak” në javët 01 – 25 të vitit 2013 dhe të vitit 2014.
Numri i rasteve.**




Në javën 25 të vitit 2014 numri i rasteve të “Diarre pa gjak” është 16% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarresë pa gjak” sipas grupmoshës në javën 25-të të vitit 2014. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 24 dhe javën 25 të vitit 2014. Incidenca (raste/10.000)



Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 25-të sipas rretheve, në përqindje.

